



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 150, datë 25.11.2021

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 2, 5 DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Ligjit nr.44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me Ligjin nr. 97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituese nga disa programe të proçesit të rindërtimit” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, Urdhërit nr. 164, datë 01.07.2020 “Për ngritjen e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e proçesit të rindërtimit”, i ndryshuar, të raportit me nr. 943/44 prot., datë 19.11.2021 të Komisionit të Posaçëm, si dhe sipas relacionit të hartuar nga ky komision, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative Nr.1 , sipas aneksit 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 2, sipas aneksit 2 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative 5, sipas aneksit 3 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Miratimin e listës së përfituesve hartuar nga Komisioni i Posaçëm për subjektet përfituese nga programi i procesit të rindërtimit të banesave individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 në Njësinë Administrative Ishëm, sipas aneksit 4 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.11.2021

ANEKSI I. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.1

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	54948	TURI	QANI	JASINI	4	PRISHJE	PO



ANEKSI 2. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.2

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	76083	GERALD	GJERGJ	DAUTAJ	3	PRISHJE	PO
2	35711	RABIJE	FEZULLA	IBRO	2	PRISHJE	PO



ANEKSI 3. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE NR.5

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	28828	SHPRESA	RAMAZAN	KIPTIU	1	PRISHJE	PO

SH. D. DURRES

ANEKSI 4. SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHEM

NR	NUMRI APLIKIMIT	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	PËRBËRJA FAMILJARE	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZES	SUBJEKTE PERFITUESE
1	20885	SHYQYRI	SELMAN	MESITI	7	PRISHJE	PO

ANNA
KURRES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 941 / prot.
11

Durrës, më 10.12 .2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

13.12.21 12467/11

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.150 datë 25.11.2021 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr 1,2,5 dhe Ishëm, Bashkia Durrës që do të përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

R. Nasto

